

VENDIM
Nr. 137, datë 22.2.2012

PËR LICENCIMIN E KOLEGJIT PROFESIONAL “ARGENT”, SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e kolegjit profesional “ARGENT”, në emër të shoqërisë “ARGENTI”, i cili do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Shkodrës.

2. Kolegji profesional “ARGENTI”, Shkodër, të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë, me kohëzgjatje normale 3 (tri) vite akademike dhe me realizimin e së paku 180 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë e nivelit të parë “Bachelor”, në:

- a) Edukim fizik dhe sporte;
- b) Mësues i arsimit fillor;
- c) Menaxhim, hoteleri dhe restorante;
- ç) Marketing turizmi dhe mikpritje;
- d) Jurist administrate dhe sekretar gjyqësor.

3. Kolegji profesional “ARGENT”, Shkodër, ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Ministri lëshon lejen, pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

4. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

5. Kolegji profesional “ARGENT”, Shkodër, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha